

AKTIVITET 11

VIZITA NË SHKOLLA TË TJERA PROFESIONALE

Në kuadër të Këshillimit për karrierën e nxënësve të shkollës “Ismail Qemali”, ne i orientuam ato drejt shkollave profesionale. Konkretisht, në shkollën “Hamdi Bushati” në datën e ditëve të hapura, nxënësit u njohën nga afër me ambientet e shkollës dhe morën informacion për shkollën dhe arsimin profesional nëpërmjet orëve të hapura.

Në takimin me drejtorinë e shkollës, pas prezantimit të qëllimit të projektit tonë, morëm të dhëna mbi numrin e nxënësve të dalë nga shkolla “Ismail Qemali” dhe që ndjekin arsimin profesional pranë kësaj shkolle gjatë një viti dhe gjatë viteve.

Po në kuadër të projektit tonë, stafi i shkollës “Arben Broci”, u takua me nxënësit e klasave të 9^{ta} të shkollës “Ismail Qemali”, të cilët informuan dhe njohën me prioritetet që ofron kjo shkollë.

Pas informimit të nxënësve nga stafi mësimor ne morëm pjesë në ambientet e shkollës industriale “Arben Broci” në një trajnim në lëndën TIK me temë “Vajzat në TIK” në kuadër të nismës për barazi gjinore në të cilin pjesëmarrësit u pajisën edhe me certifikatën përkatëse.













albanianskills
We promote skills



DC-VET WB

Certifikatë Pjesëmarrje

VAJZAT NË TIK 2024

I JEPET

Raisa Halili

**Trajnim në TIK i mbajtur në kuadër të aktiviteteve të
"Ditës Ndërkombëtare të Vajzave në Teknologji",
më 16 Prill 2024 në Shkollën Teknike "Arben Broci", Shkodër.**



Në Kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Vajzave në TIK



